

# LULËZO SHQIPËRI



# LULËZO SHQIPËRI

Versioni elektronik i ketij libri u krijua nga <a href="http://www.enverhoxha.ru">http://www.enverhoxha.ru</a>

La version électronique du livre était créée par <a href="http://www.enverhoxha.ru">http://www.enverhoxha.ru</a>

## LULËZO SHQIPËRI

ALBUM I ILUSTRUAR ME RASTIN E
 20 VJETORIT TË ÇLIRIMIT T'ATDHEUT —

Hartuar nga VEFIK QERIMI

N. SH. BOTIMEVE "NAIM FRASHËRI" Tiranë Nëndor 1964 Piktor: VASIL LALO

#### FOTOGRAFITE:

- J. Manoli, N. Kodheli, N. Stefani, J. Ristani,
- M. Kallfa, S. Kokona, M. Progonati, S. Bej,
- P. Kumi, Rr. Berisha.

## FLEURIT ALBANIE

### ALBUM ILLUSTRE A L'OCCASION DU XXème ANNIVERSAIRE DE LA LIBERATION DE LA PATRIE

Rédigé par VEFIK QERIMI

EDITIONS D'ETAT "NAIM FRASHËRI" TIRANA, NOVEMBRE 1964 PEINTRE: VASIL LALO

Les photographies sont de

- J. Manoli, N. Kodheli, N. Stefani,
- J. Ristani, M. Kallfa, S. Kokona,
- M. Progonati, S. Bej, P. Kumi,
- Rr. Berisha.

#### KY ALBUM U KUSHTOHET:

Deshmoreve dhe luftetareve te lirise, ndertonjesve heroike te socializmit qe me gjakun, djersen dhe mendjen e tyre, nen udheheqjen larg-pamese te partise bodhen themelet e Shqiperise socialiste.

#### CET ALBUM EST DEDIE

Aux martyres et combattants de la liberté, aux édificateurs héroïques du socialisme, qui en versant leur sang, leur sueur et donnant tout leur savoir, sous la direction clairvoyante du Parti, jetèrent les fondements de l'Albanie socialiste

#### *MIREMENGJES ATDHEU IM!*

Për Shqipërinë
Ditët e mira
Paskëtaj vinë
.....
Lum kush të rronjë
Ta shohë zonjë

Kështu e ëndëronte Shqipërinë në mbarim të shekullit të 19-të poeti ynë kombëtar Naim Frashëri, në një kohë kur Atdheu lëngonte nën zgjedhën e rëndë otomane, kur edhe të shkruarit shqip ndëshkohej me rreptësi si krim.

Tani, pas më shumë se një gjysëm shekulli, hidhni një vështrim Shqiperisë, soditni pamjen që kanë marë qytetet dhe fshatrat e saj, malet, lumenjtë, pyjet dhe fushat e lulëzuara të sajë. Takohuni dhe njihuni sot me njerëzit e saj, stërniprit e Naimit: burrat, gratë, punëtorët dhe intelektualët e saj.

Oxhaqet gjigande të uzinave dhe kombinateve të Shqiperisë që ngrihen drejt qiellit, pallatet e larta, rrugët plot gjallëri të qyteteve dhe fshatrave të saj të rilindur, sirenat e trenave dhe të vaporeve të saj, thirrjet e gëzuara të fëmijëve të saj që rriten plot shëndet nën diellin e lirisë — të gjitha këto do t'ju thonë:

Për Shqiperinë ditët e mira që ëndëronte Naimi, aguan 20 vjet më parë, në atë mëngjes të paharruar Nëndori dhe sot shihni si shkëlqejnë me tërë madhështinë dhe bukurinë e tyre. Si asnjëherë në historinë e jetës shqiptare vendin e Skënderbeut legjendar dhe të Ismail Qemalit, të Selam Musait e të Avni Rustemit, të Bajram Currit e të Qemal Stafës, Shqipërinë tonë të shtrenjtë që u la me gjakun e mijra e mijra patriotëve, e shohim sot *Zonjë* të vërtetë, ashtu siç deshte poeti ynë kombëtar.

Edhe mendja, edhe zemra e çdo shqiptari drejtohet sot tek ata qe me urtesi dhe kurajo te papare kane ditur te marrin ne dore flamurin e pathyshem te Skenderbeut, te çajne dallge e rrebeshe te panumurta, te kurorezojne me fitore epopene me te lavdishme te historise sone e te bejne realitet endrat me te bukura dhe me te guximshme te patrioteve tane te Rilindjes: Partia e Punes se Shqiperise dhe udheheqesi i jone shume i dashur shoku Enver Hoxha.

Të mëdha e të rënda ishin plagët që mbante në trup Atdheu ynë 20 vjet më parë:

Nga lufta humbën jetën 7,3% e popullsisë shqiptare. U shkatëruan 1600 qëndra banimi, prej të cilave 1500 fshatra, 40 qytete me rreth 61.000 ndërtesa, u dëmtua një e treta e gjësë së gjallë: nje dëm i përgjithshëm material që arrin në 1 miljard dollarë. Ndërsa mesatarja e përbotëshme e dëmit material për frymë të shkaktuar nga lufta ishte 146 dollarë, Gjermania e kishte 721, Italia 232, Franca 557, Anglia 145, Hollanda 626, Belgjika 357, Greqia 604, Jugosllavia 705, kurse *Shqiperia 934 dollarë*.

E filluam nga gjéndja e shtetit më të prapambetur të Europës. Bullgaria, peshën specifike të prodhimit industrial karshi prodhimit të përgjithshëm të ekonomisë kombëtare e kishte 24,8%, Rumania 34%, Polonia 47%, Hungaria 42%, Çekosllovakia 57%, *Shqiperia vetëm 9,8%*.

Si drita e diellit shkëlqen sot me madhështi godina vigane e socializm.it që populli ynë ngriti nën udhëheqjen e urtë e larg-pamëse të Partisë. Në 20 vjet, 32,4 herë e rritëm prodhimin e përgjithshëm industrial. U zhduk përgjithmonë pamja e dikurshme e fshatit shqiptar me driza e kasolle dhe lindi fshati ynë socialist, ku vendin e kandilit e të pishës po e zen drita elektrike; prodhimi përgjithshëm bujqësor u rrit afro dy herë e gjysëm.

Shqiperia e dikurshme me 85% të popullsisë analfabete sot ka universitetin dhe nga të katër anët e vëndit shkollat e saj, ku në çdo katër veta një mëson; ka ushtrinë e madhe të kuadrove të saj, ingjinierët, agronomët, mjekët, shkencëtarët dhe specialistët e saj të mrekullueshëm që kanë në dorë dhe kryejnë me sukses vepra të guximëshme të ndërtimit socialist.

Le t'i hedhim një vështrim, nëpërmjet faqeve të këtij albumi, fytyrës që ka marë sot Atdheu ynë i dashur!

Si kurrë ndonjë herë në historinë tonë kombëtare, Shqiperia socialiste e paqëdashëse, në jubileun e saj të 20-të qëndron shkëmb graniti, e bashkuar rreth Partisë së lavdishme të Punës dhe shokut Enver Hoxha, luftëtare e fuqishme dhe e pamposhtur për çështjen e socializmit e komunizmit, duke i treguar botës se ajo ka zot një popull që armikut kurrë nuk ia ktheu kurrizin, që asnjë herë nuk u ul në gjunjë.

Si kurrë ndonjëherë shpërthen në këto ditë të hareshme feste përshëndetja e cdo zëmre shqiptare me fjalët e poetit të ditëve tona:

Mire mëngjes Atdheu im! Ne me ty jemi krenar Në gjirin tënd një popull trim Lavdi i këndon truallit shqiptar.

#### BONJOUR O MA PATRIE!

Pour l'Albanie Les jours de bonheur Commencent aujourd'hui

Heureux celui qui Maîtresse la verra.

. . . . . . . . . . . . . . . .

C'est ainsi que rêvait de l'Albanie, vers la fin du XIXème siècle, notre poète national, Naim Frashëri, en un moment où la Patrie gémissait sous le lourd joug otoman, lorsque même écrire en albanais constituait un crime sévèrement puni.

Jetez donc aujourd'hui, plus d'un demi-siècle après, un coup d'œil sur l'Albanie, contemplez les changements subis par les villes et villages, par les monts et rivières, par les forêts et par les champs fleuris de ce pays héroïque. Faites la connaissance de ses hommes, des arrières petits-neveux de Naim, hommes, femmes, ouvriers, intellectuels, parlez avec eux.

Les cheminées géantes des usines et des combinats de l'Albanie, qui s'élancent vers le ciel, les blocs de constructions à plusieurs étages, les rues pleines d'animation de ses villes et villages rendus à la vie, les sirènes de ses trains et bateaux, le joyeux gazouilli de ses enfants heureux qui grandissent pleins de santé sous les rayons du soleil de la liberté — tout cela vous dira:

"Pour l'Albanie, les jours heureux dont Naim rêvait, virent leur aube se lever il y a vingt ans de ça, en cet inoubliable matin de Novembre et maintenant regardez-les s'épanouir ces jours dans toute leur beauté, dans toute leur splendeur. Aujourd'hui, comme jamais auparavant dans l'histoire de la vie albanaise, nous voyons la Patrie du légendaire Skënderbé et d'Ismail Qemal, de Selam Musa et Avni Rustemi, de Bajram Curri et de Qemal Stafa, notre Albanie sacrée qui fut couverte du sang de ses milliers de patriotes, vraie maîtresse de ses destinées, comme le voulait notre poète national."

Et la pensée et le cœur de tout Albanais s'élève aujourd'hui vers ceux qui, avec sagesse et courage inouï, ont su prendre en main le drapeau invincible de Skënderbé, traverser des flots en furie et d'innombrables tempêtes, couronner de victoire la plus glorieuse épopée de notre histoire et faire une réalité des rêves les plus beaux et les plus audacieux de nos patriotes de la renaissance: le Parti du Travail d'Albanie et notre guide bien-aimé le camarade Enver Hodja.

Grandes et graves étaient les plaies de notre Patrie il y a vingt ans.

Dans cette guerre avait péri le 7,3% de la population albanaise. Pendant la guerre et lors de la retraite de l'ennemi, 48 ponts, d'une longueur de 5,5 km, avaient été détruits ou faits sauter, près de 2,5 km d'installations portuaires, 1.600 centres habités, dont 1.500 villages, 40 villes avec près de 61.000 maisons furent détruites, on vit périr le tiers du bétail; la perte matérielle globale atteignait un milliard de dollars. Tandis que la moyenne mondiale des pertes matérielles par habitant, causées par la guerre était de 146 dollars, cette moyenne pour l'Allemagne était de 721, pour l'Italie 232, pour la France 557, pour l'Angleterre 145, pour les Pays-Bas 626, pour la Belgique 357, pour la Grèce 604, pour la Yougoslavie 705, mais pour l'Albanie elle atteignait le chiffre de 934 dollars.

Nous avons recommencé notre vie partant d'un Etat qui était le plus arriéré de l'Europe. Pour la Bulgarie, le Poids spécifique de la production industrielle par rapport à la production globale de l'économie nationale était de 24,8% pour la Roumanie de 34%, pour la Pologne 47%, pour la Hongrie 42%, pour la Tchécoslovaquie 57% et **pour l'Albanie seulement 9,8%.** 

Mais aujourd'hui l'édifice grandiose du socialisme que notre peuple érigea sous la sage et clairvoyante direction du Parti, brille comme la lumière du soleil. En 20 ans, nous avons multiplié par plus de 30 notre production industrielle. La vue du village albanais peuplé de ronces et chaumines délabrées disparut à jamais et un village nouveau, notre village socialiste, où la veilleuse ou la torche a été remplacée par la lampe électrique, a vu le jour et la production générale agricole s'accrut de presque deux fois et demie.

L'Albanie, jadis avec une population à 85% d'illettrés, aujourd'hui a son université et des milliers d'écoles parsemées partout dans le pays où sur quatre personnes une va à l'école; elle a son armée de cadres, ses ingénieurs, ses agronomes, ses médecins, ses hommes de science et ses merveilleux spécialistes qui construisent et portent à terme avec succès les ouvrages hardis de l'édification socialiste.

Jetons un regard, parcourant les pages de cet album, à ce nouveau visage de notre chère Patrie.

Aujourd'hui, comme jamais au cours de son histoire, l'Albanie socialiste et pacifique, dans cette fête jubilaire de son vingtième anniversaire se dresse comme un bloc de granit, unie autour du glorieux Parti du Travail et du camarade Enver Hodja, combattante puissante et invincible de la cause du socialisme et du communisme, montrant au monde qu'elle a comme maître un peuple, qui ne montra jamais le dos à l'ennemi, qui jamais ne s'agenouilla.

Plus forte que jamais jaillit aujourd'hui, en ces jours de joie le souhait de chaque cœur albanais avec les paroles du poète contemporain:

Bonjour, bonjour, ô ma Patrie! Notre orgueil, notre idéal. Dans ton sein, un peuple hardi, Chante les gloires du sol natal!



Malet shqipëtare: fole shqiponjash, dëshmimtarë të përjetëshëm të luftrave shekullore që janë bërë për lirinë e Atdheut!

Les montagnes d'Albanie: aires d'aigles, éternels témoins des luttes séculaires pour la liberté de la Patrie!



SHQIPËRIA SOCIALISTE MBUSHI 20 VJETË E sotme e lumtur. . .

L'ALBANIE SOCIALISTE A VINGT ANS! L'heureux présent...

. . . E ardhëshme e lulëzuar.

...l'avenir prospère.





KËTU U HODHËN THEMELET E JETËS SË RE Në këtë shtëpi të thjeshtë, më 8 Nëndor 1941 lindi dielli i jetës sonë: Partia Komuniste Shqiptare.

C'EST ICI QUE FURENT JETES LES FONDEMENTS DE LA VIE NOUVELLE

Dans cette maison simple et petite, le 8 Novembre 1941, se levait le soleil de notre vie: Le Parti Communiste Albanais, venait d'être fondé.



Selia e Komitetit Qendror të PPSH.

Le siège du Comité Central du Parti du Travail d'Albanie.

"MBARE POPULLI YNE, TE GJITHE KOMUNISTET TANE KRENOHEN PER PARTINE E TYRE, SEPSE VETEM NEN UDHEHEQJEN E SAJ TE URTE, LARGPAMESE E TE GUXIMESHME JANE BERE DHE PO BEHEN REALITET ENDRAT ME TE BUKURA TË PUNONJESVE TANE".


ENVER

"TOUT NOTRE PEUPLE, TOUS NOS COMMUNISTES SONT FIERS DE LEUR PARTI, CAR C'EST SEULE-MENT SOUS SA DIRECTION SAGE, CLAIRVOYANTE ET HARDIE QUE DEVINRENT REALITE LES PLUS BEAUX REVES DE NOS TRAVAILLEURS".

ENVER

Shoku Enver Hoxha, Sekretar i Parë i K.Q. të P.P.SH.







Ndërsa më 1938 Shqipëria prodhonte 35 cm. linear tekstile të pambukta për frymë, sot prodhon 16 metro linear. Kombinati i tekstileve "Stalin" një nga veprat e para te ndërtimit tonë socialist.



Tandis qu'en 1938 l'Albanie produisait 35 centimètres de coton par habitant, aujourd'hui cette production est de 16 mètres par habitant. Le combinat des textiles "Staline", un des premiers ouvrages de notre construction socialiste.

#### RRITJA E PRODHIMIT TË PERGJITHESHEM INDUSTRIAL NE SHQIPERI PËR VITET 1950, 1955, 1960, 1963 NË KRAHASIM ME VITIN 1938. —





Industria ushqimore në Shqipëri sot prodhon 28,8 herë më shumë se më 1938. Kombinati ushqimor "Ali Kelmendi" në Tiranë.

L'industrie alimentaire produit actuellement en Albanie 28,8 fois plus qu'en 1938. Le combinat des produits alimentaires "Ali Kelemendi".



Kështu ishte më 1944 fusha moçalishte e Maliqit

- A përnjimend dikur shoku mësues Maliqi i bukur s'ishte veçse knetë?
   Po vogëlushe, por Partia jonë ndryshoi natyrën, knetës i dha jetë.


- Telle apparaissait en 1944 la plaine marécageuse de Maliq.

   Est-ce vrai, camarade instituteur, que jadis ce joli Maliq n'était qu'un marais?
  - Mais oui, petite, notre Parti a transformé la nature et donné vie au marais.



Në zemër të kënetës lindi industria e sheqerit shqiptar, e cila në krahasim me vitin 1950 (Viti i parë i prodhimit) më 1963 e rriti prodhimin 19 herë.

Du cœur du marais se leva notre industrie sucrière, qui par rapport à l'année 1950 (la première année de sa mise en exploitation) avait en 1963 augmenté sa production de 19 fois.



PA ÇEMENTO S'KA NDËHTIME Shqipëria sot prodhon 14 herë më shumë çemento se më 1938. Fabrika e çementos "V.I. Lenin" — Vlorë.

IL N'Y A PAS DE CONSTRUC-TIONS SANS CIMENT Aujourd'hui l'Albanie produit 14 fois plus de ciment qu'en 1938. La fabrique de ciment "V.I. Lénine" à Vlora.




#### PA NDËRTIME S'KA JETË TË LUMTUR

Pas çlirimit gjer ne fund të vitit 1963 janë ngritur aq ndërtesa banimi sa mund të strehohej një popullsi më e madhe se ajo e të gjitha qyteteve që kishte Shqiperia përpara luftës.
Qiranë mujore të banesës punëtori shqiptar e shlyen me t'ardhurat

e një dite pune.


IL N'Y A PAS DE VIE HEUREUSE SANS CONSTRUCTIONS Depuis la libération et jusqu'à la fin de 1963 l'ensemble des maisons d'habitations construites pouvait abriter une population supérieure à celle de toutes les villes d'Albanie d'avant la guerre prises ensemble.

Le salaire d'une seule journée de l'ouvrier albanais suffit pour payer le loyer mensuel de sa maison.




ELEKTRIFIKIMIN E VENDIT PARTIA E KONSIDERON KUSHT TË DOMOSDOSHËM PËR NDËRTIMIN SOCIALIST Hidrocentrali mbi lumin e Matit "Karl Marks"

L'ELECTRIFICATION DU PAYS FUT CONSIDEREE PAR LE PARTI COMME UNE CONDITION INDISPENSABLE POUR L'EDIFICATION SOCIALISTE La centrale hydro-électrique "Karl Marx" sur le fleuve Mati.



Sot Shqipëria prodhon 32 herë më shumë energji elektrike se më 1938.

La production actuelle de l'énergie électrique en Albanie est 32 fois supérieure à celle de 1938.



Më 1965 do të prodhohet 84% më shumë energji elektrike se më


Këto tela tensioni të lartë që zgjaten pa kufi Që si nuse me tela të stolisin Shqipëri Janë nervat e tua të nderura Nervat e tua të hekurta

En 1965 la production de l'énergie électrique sera 85% supérieure à celle de 1960.

Ces lignes de haute tension qui s'allongent sans fin, et qui te parent comme une jeune mariée Sont le réseau de tes nerfs tendus


De tes nerfs avec l'acier soudés

De tes nerfs de fer Albanie!




Pamje nga ndërtimi i hidroçentralit "Frederik Engels" në Shkopet (vizatim S. Kaceli).

Vue de la construction de la centrale hydroélectrique "Fréderik Engels" à Shkopet (dessin de S. Kaceli).



TË GJITHA BURIMET E NËNTOKËS SHQIPTARE, DIKUR OBJEKT PLANESH GRABITQARE PËR KOLONIZATORËT E HUAJ, TANI JANË PASURI E POPULLIT.
Krahas shtimit të vend-burimeve të naftës, lindi për të parën herë dhe industria e përpunimit të saj, e cila më 1963 e rriti sasinë e naftës së përpunuar afro 12 herë më shumë se më 1946. Pamje nga rafineria e naftës — Cerrik.



TOUTES LES RICHESSES DU SOUS-SOL ALBANAIS, JADIS OBJET DES PLANS RAPACES DES COLONISATEURS ETRANGERS, SONT AUJOURD'HUI LA PROPRIETE DU PEUPLE. De pair avec l'augmentation du nombre des gisements pétrolifères, naquit aussi, pour la première fois en Albanie, l'industrie de raffinage, qui en 1963 donnait presque plus de 12 fois d'huile traitée qu'en 1946.

Vue de la raffinerie de pétrole à Cerrik.



MINIERA TË REJA — QYTETE TË RINJ Nxjerja e qymyrgurit më 1963 u rrit 68 herë më shumë se më 1938. Pamje nga miniera e qymyrgurit në Memaliaj.

NOUVELLES MINES — VILLES NOUVELLES . . . L'extraction de la houille en 1963 était de 68 fois supérieure à celle de 1938. Vue de la mine de houille de Mémaliaj.



Kromi filloi të çfrytëzohet vetëm pas çlirimit dhe më 1963 nxjerja e tij u shtua 42 herë në krahasim me vitin 1950. Pamje e qytetit të ri të minatorëve të kromit — Bulqizë.


Les mines de chrome ne furent exploitées qu'après la libération et en 1963 l'extraction de ce minéral était de 42 fois supérieure à celle de l'année 1950.

Vue de la nouvelle ville des mineurs du chrome-Bulqiza.



Ti japim Atdheut më shumë, më mirë dhe më lirë — kjo është parulla e ditës e brigadave të punës socialiste.

Donnons à la Patrie des produits toujours en plus grande quantité, de meilleure qualité et meilleur marché — tel est le mot d'ordre des brigades du travail socialiste.





JETE MARRIN DHE QYTETET E VJETËR Kruja, Kryeqyteti i Skënderbeut legjendar nën udhëheqjen e të cilit Shqipëria jo vetëm mbrojti lirinë e saj por shpëtoi edhe qytetërimin europian.

ET LA VIE RENAIT DANS LES VIEILLES VILLES AUSSI Kruja, capitale du légendaire Skënderbe, sous la direction duquel l'Albanie non seulement défendit sa liberté mais sauva aussi la civilisation européenne.




Peshkopia — qytet verior pranë maleve të Korabit ëshë rritur e zbukuruar.

Peshkopia — ville du nord près des monts du Korabi s'est agrandie et embellie.



Berati "qyteti i një mijë dritareve" me një të kaluar të lashtë por edhe me një të-ardhme industriale.

Berat "la ville aux mille fenêtres" avec un passé historique et un avenir industriel.



Pranë kalasë mijëvjeçare po ngrihet Kombinati i tekstileve "Mao Ce Dun" monument i ri i epokës së re socialiste.

Aux pieds de la forteresse millénaire s'érige le Combinat du textile "Mao Tsé-toung", nouveau monument de la nouvelle époque socialiste.



GJITHSHKA QË NDËRTOHET NË SHQIPËRI ËSHTE VEPER E MENDJEVE TË NDRITURA E DUARVE T'ARTA TË KUADROVE TONA QË U PREGATITEN NËN KUJDESIN E PARTISË E TË PUSHTETIT POPULLOR

TOUT CE QUI SE CONSTRUIT EN ALBANIE EST L'ŒUVRE DES CERVEAUX ILLUMINES ET DES MAINS DE FEE DE NOS CADRES PREPARES SOUS LA SOLLICITUDE DU PARTI ET DU POUVOIR POPULAIRE

Ndërsa më 1938 Shqipëria kishte vetëm 80 ingjinierë dhe agronomë, sot ka më shumë se 2588 dhe në fund të vitit 1965 do të ketë 3440 ingjinierë e agronomë kurse numuri i përgjithshem i kuadrove të larta më 1965 do të arrijë në 9700.

Tandis qu'en 1938 l'Albanie n'avait que 80 ingénieurs et agronomes, aujourd'hui leur nombre est de 2.588 et à la fin de 1965 il y aura 3.440 ingénieurs et agronomes et le nombre des cadres supérieurs en cette même année sera de 9.700.





I jati i këtij djaloshi nga Labëria tërë jetën ka mbajtur krrabën e bariut. Por erdhën ditë të tjera dhe kryeingjinieri gjeollog, që mbaroi universitetin mban sot çekiçin e zbuluesit të thesarëve të nëntokës sonë të pasur.


Le père de ce jeune homme de Labëria avait tenu toute sa vie la houlette du berger. Mais la vie changea et l'ingénieur géologue en chef tient aujourd'hui dans sa main le martelet des inventeurs des trésors de notre sous-sol si riche. Në të katër anët e vëndit janë shpërndarë ekipet gjeollogji-ke në kërkim të mineraleve të çmuarshme. Sa qiell i pastërt qielli yt, atdhe! Në gjinin tënd thesare plot ti ke.

Les équipes de géologues sont dans les quatre coins du pays à la recherche des minéraux précieux.

Limpide et clair est, ô ma Patrie, ton ciel!

Dans ton sein, tes trésors sont éternels.






Dikur këto shkrepa ushtonin nga pushka partizane, tani nga motorët e fuqishëm të sondave të çpimit.

Dans ces rochers jadis retentissaient les coups de fusil des partisans. Aujourd'hui c'est le bruit des puissants moteurs des perforateurs.

Dhe ja një çast i gëzuar: Burime të reja të naftës e të gazit metan që kanë fjetur në shekuj shpërthejnë me furi nga nëntoka.

Moments de joie: De nouvelles sources d'huile et de gaz métane, endormies pendant des siècles dans l'antre de la terre, jaillissent avec une force indomptable.




ARMIQTË E PARTISË E TË POPULLIT TONË IMPERIALISTËT DHE REVIZIONISTËT MODERNË U PËRPOQËN ME BLLOKADA E KOMPLLOTE TË PENGOJNË NDËRTIMIN TONË SOCIALIST. POR POPULLI UA GRISI PLANET NË DUAR. SI KURRË NDONJËHERË SHPËRTHYEN INISIATIVAT PATRIOTIKE TË PUNONJËSVE PËR PLOTËSIMIN DHE TEJKALIMIN E DETYRAVE TË PLANIT.

Në qytetin e naftës ndërtohet me sukses uzina e koksifikimit të bitumit.

LES IMPERIALISTES ET LES REVISIONNISTES MODERNES, ENNEMIS DE NOTRE PATRIE ET DE NOTRE PEUPLE, TENTERENT PAR TOUS LES MOYENS, ORGANISANT DES BLOCUS ET DES COMPLOTS, D'ENRAYER NOTRE EDIFICATION SOCIALISTE. MAIS LE PEUPLE ANEANTIT LEURS PLANS AVANT MEME QU'ILS FUSSENT MIS EN ŒUVRE. LES INITIATIVES PATRIOTIQUES DES TRAVAILLEURS POUR REALISER ET DEPASSER LES TACHES DU PLAN DE L'ETAT FURENT DE PLUS EN PLUS NOMBREUSES.

Dans la ville du pétrole on construit l'usine pour la cokéfaction du bitume.





Elbasani i lashtë, sot qëndër industriale, do të ketë edhe uzinën e metalurgjisë së zezë, së cilës poeti i këndon:

Metali do të derdhet

Metali i parë

Shqipëria do të japë metal të saj
Çelik të gjallë

Maketi i uzinës së metalurgjisë së zezë që po ngrihet në qytetin e Elbasanit.

La ville d'Elbasan déjà connue dans l'antiquité, aujourd'hui est devenue un centre industriel important. Actuellement on y construit l'usine de la sidérurgie dont le poète parle en ces termes:

Et le métal coulera


Notre premier métal
L'Albanie produira son métal
Son acier pur

Maquette de l'usine de sidérurgie en voie de construction dans la ville d'Elbasan



Të mëdha janë sukseset e punonjësve të uzinës "Enver" duart e të cilëve dhanë motorët e parë diezel "Shqiponja".

Les succès des travailleurs de l'usine "Enver" sont grands. De leurs mains agiles sont sortis les premiers moteurs diezel "Shqiponja".



Por akoma më të mëdha janë perspektivat e industrisë mekanike e cila më 1963 e rriti prodhimin 32,9 herë më shumë se më 1938 dhe më 1965 do të sigurojë 50% të nevojave të vendit me pjesë këmbimi.

Maketi i uzinës së pjesëve të kembimit për traktorë që ngrihet në Tiranë.

Mais plus grandes encore sont les perspectives de l'industrie mécanique dont la production en 1963 était 32,9 fois supérieure à celle de 1938 et qui, en 1965 assurera le 50% des besoins du pays en pièces de rechange.

Maquette de l'usine des pièces de rechange pour tracteurs qui est en voie de construction à Tirana.



Qelqi dhe porcelani në Shqiperi gjithmonë kanë qenë artikuj importi. Kjo degë e re e industrisë sonë që lindi pas çlirimit e shtoi prodhimin 69,7 herë në vitin 1963 në krahasim me vitin 1950.

Le verre et la porcelaine avaient toujours été un article d'importation pour l'Albanie. Cette nouvelle branche de notre industrie, qui vit le jour après la libération, en 1963 augmenta sa production de 69,7 fois par rapport à l'année 1950.



TË SHTOJË ASORTIMENTET, TË NGREJË CILËSINË E PRODHIMIT — KJO ËSHTË DETYRA E DITËS E INDUSTRISË SË LEHTË SHQIPTARE E CILA NË KRAHASIM ME VITIN 1938 MË 1963 PRODHOI 28,5 HERË MË SHUMË.
Të përmendura janë prodhimet shqiptare të xunkthit që preferohen shumë në tregjet e jashtme.

MULTIPLIER LES ASSORTIMENTS, AMELIORER LA QUALITE DE LA PRODUCTION — VOILA LE DEVOIR DE L'INDUSTRIE LEGERE ALBANAISE, LAQUELLE EN 1963 PRODUISIT 28,5 FOIS PLUS QU'EN 1938

Les objets en vannerie d'Albanie sont bien connus et appréciés sur le marché extérieur.



VËNDIN E BUJQËSISË PRIMITIVE, TË PARMENDËS SE DRURIT, ME MARËDHËNJET GJYSËM FEUDALE NË PRODHIM, E ZURI BUJQËSIA SOCIALISTE E MEKANIZUAR. Në krahasim me vitin 1938, sipërfaqja e tokës nën kulturë më 1963 u rrit 200.000 hektarë më shumë, kurse prodhimi i përgjithëshëm bujqësor afro dy herë e gjysëm.



L'AGRICULTURE PRIMITIVE AVEC DES CHARRUES EN BOIS, OU EXISTAIENT DES RAPPORTS SEMI-FEODAUX DANS LA PRODUCTION, CEDA LA PLACE A L'AGRICULTURE SOCIALISTE MECANISEE.

La superficie sous culture en 1963 avait 200.000 ha de plus qu'en 1938, tandis que la production globale agricole était près de 2,5 fois supérieure.



KOLEKTIVIZIMI I BUJQESISE QE PARTIA E CILESON SI NJE REVOLUCION TE DYTE, BERI TE RILINDIN FORCA TE GJALLA TE FSHATIT QE JU PERVESHEN PUNËS PRO-DHUESE PER NJE JETE TE PASUR E TE BEGATESHME. Detyra kryesore e bujqesise eshte sot rritja e prodhimit te drithrave.

LA COLLECTIVISATION DE L'AGRICULTURE, QUE LE PARTI QUALIFIE DE DEUXIEME REVOLUTION, FIT RENAITRE LES FORCES VIVES DU VILLAGE QUI SE MIRENT AU TRAVAIL PRODUCTIF POUR UNE VIE RICHE ET PROSPERE. La tâche principale dans l'agriculture est toujours l'accroissement de la production des céréales.

Pambuku, lënda e parë për industrinë tekstile, më 1963 u rrit tri herë e gjysëm më shumë në krahasim me vitin 1950.

Le coton, la matière première de l'industrie textile en 1963 a vu sa production s'accroître de plus de trois fois et demie par rapport à celle de l'année 1950.






Çdo pëllëmbë toke ta kthejmë në burim begatie! Kjo është parulla e frutikultorëve, me punën e të cilëve çdo ditë ndryshon e zbukurohet pejsazhi shqiptar.
Pamja e plantacioneve të reja të pemëve frutore në Peshkopi.

Transformer chaque pouce de terrain en une source de prospérité! Voilà le mot d'ordre des arboriculteurs, dont le travail transforme et embellit chaque jour davantage le paysage albanais. Vue de nouveaux vergers à Peshkopia.




Sot Shqipëria ka pesë herë më shumë pjergulla dhe afro katër herë më shumë pemë frutore se më 1938.

Aujourd'hui l'Albanie possède cinq fois plus de vignobles et près de quatre fois plus de vergers qu'en 1938.



Sa bukuri ka tufa Sa gaz bije bagëtia... Kushtet e përshtatëshme natyrore të atdheut u lejojnë kooperativave bujqësore të zhvillojnë e të përmirësojnë gjithnjë më shumë bagëtitë e imta.

O beauté du troupeau!
O joie du petit bétail...
La nature du climat de notre pays permet aux coopératives agricoles de développer et d'améliorer leur cheptel de petit bétail.



Pamje nga Valbona (Shqiperia e veriut)


Vue de la Valbona (Albanie du nord)



Shtimi dhe përmirësimi i lopës së vëndit, një nga detyrat kryesore të punonjësve të institutit zooteknik të Shkodrës, qëndër e rëndësishme shkencore për zhvillimin e blegtorisë sonë.



L'accroissement en nombre et l'amélioration de la race des vaches du pays, est une des tâches primordiales des travailleurs de l'institut de zootechnie de Shkodra, important centre scientifique pour l'essor de notre élevage.



Pula të races "Leghorn" rriten me shumicë në fermat dhe kooperativat bujqësore.

L'élevage des poules "Leghorn" est fait sur large échelle dans nos fermes et coopératives agricoles.



Peshkimi është një burim i math për ekonominë tonë popullore.

La pêche est une grande ressource pour notre économie populaire.



PYJET SHQIPTARE: Të adhurueshme për klimën e shëndoshë të atdheut. . .

LES FORETS ALBANAISES

Magnifiques pour assurer à notre Patrie
un climat sain...



... Me vlerë të madhe për nevojat e ndërtimit socialist. Më 1963 ekonomia e jonë mori nga pyjet 50 herë më shumë lëndë druri të sharruar se më 1938.

...Très précieuses pour les besoins de l'édification socialiste. En 1963 notre économie recut de nos forêts 50 fois plus de bois débité qu'en 1938.



Në Shqipërinë socialiste ushtri dhe popull janë një.

Dans l'Albanie socialiste armée et peuple ne font qu'un.



Njëzet vjet më parë kazma dhe lopata ishin armët tona të para të ndërtimit socialist.

Në shërbim të punës sonë ndërtonjëse, sot veprojnë mjetet e mekanizuara.

Il y a vingt ans la pioche et la pelle étaient nos premières armes de l'édification socialiste. Aujourd'hui des moyens mécanisés sont au service de notre labeur édificateur.



I pajisur me mekanizma moderne porti i Durrësit është bërë sot një qëndër e madhe tregëtare e Republikës.

Doté de mécanismes modernes le port de Durrësi est devenu à l'heure actuelle un grand centre commercial de la République.



Para çlirimit Shqiperia ishte i vetmi vend bregdetar europjan pa fllotë. Ne e krijuam fllotën tonë në vitet e lavdishme të ndërtimit socialist dhe për të parën herë në histori anijet shqiptare çajnë sot detet dhe oqeanet.

Après la libération, l'Albanie était le seul pays à frontières maritimes sans flotte. Nous avons créé notre flotte au cours des glorieuses années de l'édification socialiste et, pour la première fois dans notre histoire, des bateaux albanais, battant pavillon albanais sillonnent mers et océans.



NUK KA SEKTOR TË PUNËS SONË NDËRTONJËSE KU TË MOS KETË VEND PUNA E GRUAS SHQIPTARE. Në industri për prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë.

IL N'Y A AUCUN SECTEUR DE NOTRE TRAVAIL EDIFICA-TEUR OU LA FEMME ALBANAISE N'AIT PAS SA PLACE. La voilà dans l'industrie pour la production des produits de consommation courante.

Në bujqësi për ngritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore.

La voilà dans l'agriculture, où elle contribue à élever le rendement de la production agricole.





E çmueshme është puna e gruas në laboratoret shkencore.

Bien précieux est le travail des femmes dans les laboratoires scientifiques. . .

... Dhe në institucionet shëndetësore.

... et dans les institutions sanitaires.





RUAJTJA DHE FORCIMI I SHËNDETIT TË POPULLIT, KY ËSHTË QËLLIMI FISNIK DHE HUMANITAR I PUNËS SË KUADROVE TONA MJEKËSORE, TË CILAT I PREGATIT UNIVERSITETI YNË SHTETËROR.

Shqiperia ka sot 7 herë më shumë mjekë se më 1938.


PROTEGER ET RENFORCER LA SANTE DU PEUPLE, TEL EST LE BUT NOBLE ET HUMANITAIRE DU TRAVAIL DE NOS CADRES MEDICAUX, PREPARES PAR NOTRE UNIVERSITE D'ETAT.

Il y a aujourd'hui en Albanie 7 fois plus de médecins qu'en 1938.

Kirurgjia jonë, e pajisur me aparaturat më moderne dhe me specialistë të aftë është në gjëndje të kryejë me sukses operacionet më të ndërlikuara në mushkëri e në zemër.

Notre chirurgie, dotée d'appareils les plus modernes et servie par des spécialistes capables est en état de procéder avec succès aux opérations les plus compliquées sur les poumons et le coeur.

 $\rightarrow$ 





Në të gjitha institucionet tona shënde-tësore në Shqiperi shërbimi mjekësor kryhet falas.

"Ndihma mjeksore e shtetit falas, thuhet në nenin 9 të ligjës, u jepet të gjithë shtetasve të Republikës Popullore të Shqiperisë, pavarësisht në se ata janë ose jo në marrëdhënje pune me institucionet, ndërmarrjet ose organizatat shtetërore, kooperativiste ose shoqërore".

Le service médical est gratuit dans toutes

les institutions sanitaires d'Albanie.
"L'assistance médicale d'Etat est gratuite, est-il dit dans l'article 9 de la loi, elle est assurée à tous les citoyens de la République Populaire d'Albanie, indépendamment du fait de l'existence d'un rapport de travail avec les institutions, entreprises ou organisations gouvernementales, coopérées ou sociales".



"Klasa e privilegjuar" në Shqiperi sot janë fëmijët.

Les enfants, voilà la classe privilégiée de l'Albanie.





Gjithshka për tua bërë sa më të këndëshme jetën fëmijve, të cilët i këndojnë me mirënjohje Partisë:

Ti në çdo çerdhe vogëloshe me dorën tënde na mekon
Ti nëpër kopshte bukuroshe na ve në gjumë e na mbulon
Ti je në kampet e pushimit flladi qe faqet na puth lehtë dielli që ndrit e na jep jetë.

Tout pour rendre la vie plus belle aux enfants, qui pleins de reconnaissance chantent leurs plus belles chansons pour le Parti:

Dans chaque petite crèche c'est toi

Qui de ta douce main nous nourris;
Dans les garderies c'est encore toi

Qui veille sur nous, endormis, C'est bien toi dans les camps de repos Cette brise légère qui baise nos joues Ce soleil vivifiant, éclairant tout.




Në Shqiperinë socialiste në çdo katër veta: një mëson.

Dans l'Albanie socialiste sur quatre personnes, une va à l'école.

Dashuria për teknikën lind tek brezi i ri që në moshën e njomë në rrethet e shtëpive të pionierit.

L'amour de la technique naît chez la jeune génération dès l'âge tendre dans les différents cercles des maisons du pionnier.





SI UJRAT PRANVERORE SHPËR-THEJNË TALENTET E RINISË SONË:

C'EST COMME LES EAUX PRINTA-NIERES QUE SE DEVERSENT LES TALENTS DE NOTRE JEUNESSE. A l'école de musique...



Në konservatorin tonë shtetëror. Au Conservatoire d'Etat.



SA ME SHUMË KUADRO TË ZOTËROJNË TEORINE DHE PRAKTIKËN, KY ËSHTË NJË NGA PRINCIPET THEMELORE TË SHKOLLËS SONË TË RE.

Laboratoret e universitetit kanë gjithçka që u duhet studentëve për praktikën shkencore.

AYONS LE PLUS DE CADRES POSSIBLES, MAITRES DE LA THEORIE ET DE LA PRATIQUE, VOILA UN DES PRINCIPES FONDAMENTAUX DE NOTRE NOUVELLE ECOLE.

Les laboratoires de l'Université ont tout ce qui est nécessaire aux étudiants dans leurs travaux pratiques scientifiques.



Njohja me praktikën e prodhimit është e domosdoshme për kuadrot e ardhëshme. La connaissance de la pratique de la production est nécessaire aux futurs cadres.



PAS PUNËS...

APRES LE TRAVAIL...



...ÇLODHJE Shtëpi Komode për një pushim te gëzuar janë ndërtuar ne qendrat klimaterike. Shtëpia e pushimit te puntorëve në Dhërmi.

...DU REPOS.

Des villas commodes pour un repos agréable sont construites dans des sites climatiques.

La maison de repos des travailleurs à Dhërmi.



... DHE ARGËTIM

... DES DIVERTISSEMENTS.



Të plotësohen sa më mirë nevojat e popullit — kjo është detyra e tregëtisë socialiste. Satisfaire le mieux possible les besoins du peuple — voilà la tâche du commerce socialiste.



REVOLUCIONI KULTURAL ZGJOI DËSHIRA TË MËDHA PËR DIJE E KULTURË EDHE NË SKAJAT MË TË LARGËTA TË ATDHEUT. Në vënd të sarajeve të beut e të kullave të bajraktarëve, sot në fshatin tonë shkëlqejnë më shumë se 1400 shtëpi dhe vatra kulture, që përhapin dritën e kulturës e të përparimit.

LA REVOLUTION CULTURELLE FIT NAITRE DE GRANDS DESIRS POUR SE DOTER DE SCIENCE ET DE CULTURE, MEME DANS LES COINS LES PLUS RECULES DE LA PATRIE.

A la place des palais des beys et des donjons des chefs de clan, aujourd'hui dans nos villages brillent plus de 1.400 maisons et foyers de culture, qui répandent la lumière de la culture et du progrès.



Ditëve të reja që solli Partia në malësi u këndon muza jonë popullore.

Notre muse populaire chante la gloire des jours heureux que nous a apportée le Parti.



Perëndim dielli (Vlorë)

Coucher de soleil (Vlora).



Nata buzë Adriatikut (Durrës)

La nuit sur les rivages de l'Adriatique (Durrës).



SHQIPËRIA ËSHTË E PASUR ME VARIACIONIN E KLIMËS DHE ME BUKURINË MAGJEPSE TË NATYRËS SË SAJË.

I mrekulluarshëm është plazhi shqiptar, me rërën e imtë dhe me detin e kaltërt plot jodio.


L'ALBANIE EST RICHE PAR LA VARIETE DE SON CLIMAT ET LA BEAUTE ENCHANTE-RESSE DE SA NATURE.

Les plages de l'Albanie avec leur sable doré et leur mer d'azur riche en iode sont merveilleuses.



Eskursjonet alpinistike forcojnë dhe kalitin organizmin e njeriut.

Les excursions alpinistes renforcent et trempent l'organisme.



Buzë detit Jon (Sarandë)

Sur les rives de la mer Ionienne (Saranda).



FORCË, SHËNDET, BUKURI — KËTO JANË SYNIMET E SPORTIT SHQIPTAP QË ËSHTË BËRË I MASAVE TË GJERA PUNONJËSE

Stadiume dhe sheshe sportive janë ngritur në të katër anët e Atdheut.

Ndeshje basketbolli në Pallatin e sportit "Partizani" në Kryeqytet.

FORCE, SANTE, BEAUTE — VOILA LE BUT DU SPORT ALBANAIS QUI EST DEVENU UN APANAGE DES LARGES MASSES POPULAIRES.

Des stades et des terrains de sport ont été construits dans les quatre coins de la Patrie.
Partie de basketball au palais du sport "Partizani" à Tirana.



Gara çiklistike.

Des courses cyclistes.

Poetët tanë të mëdhenj, Naimi dhe Çajupi, u kanë kushtuar vargjet më të bukura këtyre viseve të mahnitëshme të atdheut tonë, ku gurgullojnë ujra të ftohta dhe të kulluara si kristali.

Nos grands poètes, Naim et Çajupi, ont dédié leurs meilleurs vers à ces sites enchanteurs de notre Patrie, où murmurent les eaux glacées et pures des sources cristallines.





Alpet Shqiptare.

Les Alpes albanaises.

Ju dua male, ju dua pse e di: Se ku ka male ka edhe Shqiponja Se ku ka male ka edhe krenari.

Je vous aime, monts, je vous aime car je sais
Qu'en montagne il y a des aigles aussi
Et que c'est là qu'on trouve aussi la fierté!



E bukur është natyra e bregdetit shqiptar. . . Por dora e njeriut ia rrit çdo ditë bukurinë. Bregdeti i Himarës.



Belles sont les côtes albanaises. . . Mais la main de l'homme ajoute toujours à leur beauté. La riviera de Himara.



 $\leftarrow$ 

ME DASHURI I RUAJMË MONUMENTET KULTURALE TË BANORËVE TE LASHTË TË TOKËS SONË...

Pamje nga zbulime të reja të kulturës ilire në Pojan.

C'EST AVEC AMOUR ET UN SOIN JA-LOUX QUE NOUS CONSERVONS LES MONUMENTS CULTURELS DES ANTI-QUES HABITANTS DE NOTRE SOL... Vue de nouvelles découvertes de la culture Illyre à Pojan.




. . . DHE KOLORITIN NACIONAL TË KOSTUMEVE TONA POPULLORE

. . . ET LA COULEUR NATIONALE DE NOS COSTUMES POPULAIRES




Traditat luftarake dhe patriotike të të parëve — burime frymëzimi për piktorët në krijimet artistike.

Les traditions guerrières et patriotiques de nos ancêtres sont une source d'inspiration pour nos peintres dans leurs créations artistiques.



- ... Dhe për skulptorët.
- ... Ainsi que pour nos sculpteurs.



I PASUR ËSHTË REPERTUARI I TEATROVE TONA ME TEMA QË PËRJETËSOJNË LUFTËN E POPU-LIT TONË KUNDER PUSHTONJËSVE TË HUAJ: Baleti "Halili dhe Hajrija"

RICHE EST LE REPERTOIRE DE NOS THEATRES EN THEMES QUI RENDENT IMMORTELLE LA LUTTE DE NOTRE PEUPLE CONTRE LES OCCUPANTS ETRANGERS: Le ballet "Halili et Hajrija".



Drama "Familja e peshkatarit".

Le drame "La famille du pêcheur".



KËNGA, ASHTU SI PUSHKA, KANË QENË GJITHMONË SHOKË TË PA NDARË TË POPULLIT TONË TRIM DHE LIRIDASHËS.

Por vetëm pas çlirimit Shqiperia krijoi operën e saj kombëtare. Opera e parë kombëtare "Mrika" u këndon ditëve të ndërtimit tonë socialist. LE CHANT COMME LE FUSIL ONT TOUJOURS ETE LES AMIS INSEPARABLES. DE NOTRE PEUPLE HARDI ET EPRIS DE LIBERTE.

Mais ce n'est qu'après la libération que l'Albanie a créé son opéra national.

Le premier opéra national "Mrika" chante la gloire des jours de l'édification socialiste.



Edhe veprat letrare të së kaluarës marrin jetë në muzikën tonë operistike. Opera "Lulja e Kujtimit".

Mais les œuvres littéraires de notre passé font aussi partie de notre musique d'opéra. L'opéra "La fleur du souvenir".





KINEMATOGRAFIA SHQIPTARE LINDI NË PUSHTETIN POPULLOR Filmi artistik "Detyrë e posaçme" realizuar nga Kino-Studjoja "Shqiperia e Re" i kushtohet heroizmit të punonjësve të sigurimit të Shtetit, në mbrojtje të Atdheut socialist.

LE CINEMA ALBANAIS EST NE AVEC LE POUVOIR POPULAIRE Le film artistique "Mission spéciale" réalisé par le studio cinématographique "La Nouvelle Albanie" est dédié à l'héroïsme des travailleurs de la Sûreté de l'Etat, défendant la Patrie socialiste.

Talente të estradave tona.

Talents nouveaux dans nos théâtres d'estrade.



VETËM PAS ÇLIRIMIT, BOTA E NJOHU SHQIPTARIN JO VETËM SI LUFTËTAR TË PA EPUR DHE PUNËTOR POR EDHE ART-DASHËS ME NJË SHIJE TË HOLLË ARTISTIKE. Ne skenat dhe stadiumet e festivaleve ndërkombëtare, vallet tona kombëtare korrin suksese dhe fitojnë çmime.

CE N'EST QU'APRES LA LIBERATION QUE LE MONDE CONNUT L'ALBANAIS NON SEULEMENT COMME COMBATTANT INSOUMIS ET TRAVAILLEUR MAIS ENCORE COMME HOMME AUX GOUTS ARTISTIQUES DELICATS.

Sur les scènes et dans les stades des festivals internationaux, nos danses nationales ont un grand succès et remportent des prix.



Ky qitës i shkëlqyer: Ismail Kosova, bir i këtij vëndi kreshnik zuri vëndin e dytë në garat ndërkombëtare të Ganefos.

Ce tireur d'élite, Ismail Kosova, fils de ce pays de preux, a remporté la deuxième place dans les compétitions internationales des "GANEFO".



NDËRTOJMË DHE MBROJMË! Me këtë frymë luftarake jeton dhe punon populli ynë që historia e ka mësuar të jetë kurdoherë vigjilent.

Dekorata në gjoksin e këtij pioneri të malësisë: Xhelal Martinit, flet për trimërinë e tij në zbulimin dhe kapjen e armiqëve që shkelën tokën tonë arbërore.

NOUS CONSTRUISONS ET NOUS NOUS DEFENDONS — C'est avec cet esprit combatif que vit et travaille notre peuple auquel l'histoire a enseigné d'être toujours vigilant.

La médaille accrochée sur la poitrine de ce fils de nos montagnes:

La médaille accrochée sur la poitrine de ce fils de nos montagnes: Xhelal Martini, témoigne de son courage et de sa bravoure dans la découverte et l'arrestation des ennemis qui viennent souiller le sol de la Patrie.



Buzë valëve Majë maleve Atdheu ynë jeton...

Sur la crête des flots Sur les cîmes des monts Notre Patrie vit. . .



KUSHDO QE DO TE GUXOJE TE PREKË KËTË VËND TË SHENJTË DO TË THYEJË KOKËN.

QUICONQUE OSERA TOUCHER A CE PAYS SACRE, S'Y BRISERA L'ECHINE.



NË ROJE QËNDRON KURDOHERË E GATËSHME, SY PA TRËMBUR, USHTRIA JONË POPULLORE, E PAJISUR ME MJETET ME MODERNE E ME TEKNIKËN LUFTARAKE TË KLASIT TË PARË...

VIGILANTE, TOUJOURS PRETE ET VAILLANTE, NOTRE ARMEE POPULAIRE, DOTEE DES MOYENS LES PLUS MODERNES ET D'UNE TECHNIQUE GUERRIERE DE PREMIERE CLASSE, MONTE LA GARDE SUR NOS FRONTIERES...



. . . QËNDRON NJË POPULL I TËRË, QË KURDOHERË ME PARTINË NË KRYE MARSHON DREJT AGIMEVE TË REJA.

. . . C'EST AINSI QUE MONTE AUSSI LA GARDE TOUT UN PEUPLE, QUI MARCHE TOUJOURS DERRIERE SON PARTI VERS DE NOUVELLES AURORES.



## FESTE NE QYTETE DHE FSHATRA! FESTE NE ÇDO ZEMËR SHQIPTARE, QE I KENDON SOT TOKES ARBERORE:

Lulzo Shqiperi kreshnike

Siç nuk lulzove kurrë

fushave

luginave

shpalose ti flamurë

Mes miqve

dhe armiqve

ndriço margaritar

Të prin Parti

e trimave

në vrullin fitimtar!

JOUR DE FETE DANS LES VILLES ET VILLAGES! JOUR DE FETE DANS CHAQUE CŒUR ALBANAIS, QUI CHANTE AUJOURD'HUI A LA GLOIRE DE LA PATRIE.

Fleuris vaillante Albanie

Fleuris donc comme jamais

Dans les champs,

dans les vallées;

Arbore et déploie ton drapeau

Parmi les amis,

les ennemis;

Brille de tout ton éclat

Guidée par le Parti

de vaillants

Dans ton élan triomphant.



